



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

**Nr. 26 dt.07.03.1995**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij dt.07.03.1995, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Komisioni Shërbimeve Publike, për problemet e strehimit të paraqitura nga Seksioni i Strehimit i Drejtorisë së Shërbimeve Publike :

**VENDOSI**

1. Të konsideroj shkelje të rëndë, marrjen e kompetencave së Këshillit Bashkiak për të diskutuar e vendosur për problemet e strehimit dhe lidhur me këtë të dalë përgjegjsia e të merren masat e duhura.
2. Këshilli Bashkiak do të fillojë të ushtrojë këtë funksion të tij duke filluar nga data 17.10.1994.  
Këshilli Bashkiak do të gjykojë e do të marrë vendime vetëm për ato kontigjente banesash të cilat plotësojnë këto kushte :
3. Deri më datën 17.10.1994 nuk është bërë asnjë ndarje nga Seksioni i Strehimit dhe nuk është lëshuar ndonjë autorizim nga Kryetari i Bashkisë.
4. Të jetë realizuar ndërtimi i plotë dhe të jetë bërë dorëzimi Entit të Banesave konform ligjeve dhe vendimeve të Qeverisë në fuqi.
5. Ndarja e kontigjenteve të banesave do të bëhet nga Këshilli Bashkiak duke zbatuar me përpikmëri të gjitha ligjet e nxjerra nga parlamenti si dhe vendimet e Qeverisë.
6. Komisioni i Shërbimeve Publike duke zbatuar funksionet që i janë ngarkuar nga Këshilli Bashkiak të rrisë kontributin e tij lidhur me zbatimin e pikave.1, 2, 3.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**

